

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
AHMETAJ CONSULTING Sh.p.k.**

- Z. MUSTAFA AHMETAJ, atësia MUHARREM datëlindje 12.06.1985, lindur në Tiranë, dhe banues në Tiranë, Rr.Muhamet Gjollësia, Pallati Vëllezërit Kajtazi, Hyrja 2, Ap.48 me kartë identiteti ID nr.039272558 dhe nr.personal I50612040W.

ka vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është AHMETAJ CONSULTING Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga e Saraçëve, Pallati Diamand, Kati 2, Zyra Nr.1.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

- Konsulenca në fushën financiare dhe fiskale. Shërbime tatimore dhe të mbajtjes së kontabilitetit. Shërbime të administrimit të taksave dhe shërbime të tjera administrative dhe organizative. Shërbime të regjistrimit të biznesit. Shërbime të regjistrimit fillestar dhe ndryshime të tjera në regjistrin tregtar. Auditim i brendshëm i bizneseve. Hartimi i Pasqyrave Financiare. Auditimi i Pasqyrave Financiare. Analizë financiare, plane biznesi. Konsulencë në zhvillim, ri-organizime, strukturime biznesi, si dhe çdo shërbim tjetër në fushën financiare, ekonomike dhe të kontabilitetit. Kurse profesionale. Trajnime profesionale kontabiliteti dhe programe të informatizuara kontabiliteti (Financa 5, Bilanc, AlphaWeb, etj), Standartet e Kontabilitetit SKK dhe IFRS, trajnime për mbajtjen e kontabilitetit të shoqërive. Trajnime për legjislacionin tatimor dhe ligjin e biznesit. Shërbime të tjera profesionale, në fushën e trajnimit profesional, shërbime të rekrutimit të trajnimit të punonjësve dhe shërbime e veprimtari të tjera të ngjashme. Ndërmjetësim pronash të patundshme. Administrim pronash, konsulencë në investime në prona. Shërbime ndërmjetësie lidhur me shit-blerje të ndryshme, qiramarrje, shërbime imobiliare. Shërbime konsulencë marketingu dhe shërbime online marketing. Konsulencë dhe shërbime juridike, punësim dhe çdo veprimtari tjetër të ligjshme që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë. Ndërtim dhe mirëmbajtje Web-i, konsulenca biznesi, mirëmbajtje sisteme shitje online dhe platformë për zhvillim personal. Shoqëria do të bashkëpunojë me ekspertë të fushësh dhe shoqëri të tjera për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar. Gjithashtu shoqëria AHMETAJ CONSULTING shpk, si një shoqëri që zbaton përgjegjësitë sociale, do të ofrojë praktika profesionale pa pagesë për studentët e Universiteteve Publike dhe Private në Republikën e Shqipërisë.



Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 500,000 (pesëqind mijë) lekë i cili është tërësisht financiar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë të së njëjtës kategori me vlerë nominale sipas kontributit të ortakeve në kapitalin themeltar të Shoqërisë përcaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. MUSTAFA AHMETAJ, atësia MUHARREM datëlindje 12.06.1985, të cilit i përket 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 500,000 (pesëqind mijë) lekë që i korespondon 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. MUSTAFA AHMETAJ, atësia MUHARREM datëlindje 12.06.1985, lindur në Tiranë, dhe banues në Tiranë, Rr.Muhamet Gjollësja, Pallati Vellezerit Kajtazi, Hyrja 2, Ap.48 me kartë identiteti ID nr.039272558 dhe nr.personal I50612040W, emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9- Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.



10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKU I VETËM

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

AHMETAJ CONSULTING Sh.p.k

MUSTAFA AHMETAJ

MUSTAFA AHMETAJ

Data: 18.04.2024

